



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:089034

Datë: 14.01.2025

Numri i dokumentit: 06705647

C.nr.646/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtarin Nazmi Neziri, dhe procesmbajtësen Afërdita Ejupi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Y. R. nr. personal ..., nga P., të cilën e përfaqëson i autorizuari F. G., avokat nga P., Rruga "F. A.", Hyrja ..., me autorizim, kundër të paditurës Komuna e Podujevës, Drejtoria Komunale e Arsimit nga Podujeva, Rruga "N. G." pn., me objekt kontesti: Kompensimin e ushqimit-shujtave ditore, me vlerë të kontestit: 454.00 Euro, jashtë seance me dt.13.01.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- pa shqyrtim kryesor të çështjes -

APROVOHET kërkesëpadia e paditëses Y. R., nga P., në tërësi **si e bazuar**, dhe:

DETYROHET e paditura Komuna e Podujevës, Drejtoria Komunale e Arsimit nga Podujeva, Rruga "N. G." pn., që paditësit t'ia kompensojë në emër të ushqimit-shujtave ditore, për ditët e pranisë në punë dhe atë për 227 ditë të pranisë në punë, (për periudhën nga data 19.04.2021 deri me datë 21.11.2022), nga 2 euro në ditë, shumën e përgjithshme prej 454.00 euro, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 98.00 Euro, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësi, nëpërmes të autorizuarit të tij, në këtë gjykatë, ka paraqitur padi kundër të paditurës për kompensimin në emër të kërkesave të përshkruara dhe shumën e përgjithshme, si në pjesën hyrëse të këtij aktgjykimi.

Ka shtuar se është në marrëdhënie të rregullt pune te e paditura në vendin e punës mësimdhënëse. Ka theksuar se duke marrë parasysh nënshkrimin e Kontrata kolektive të Arsimit të Kosovës, Ligjit të Punës, dhe kontratës individuale nuk ka bërë kompensimin në emër të kërkesave të paditësit përkundër se i është drejtuar me kërkesë, në shumën si në pjesën hyrëse të këtij aktgjykimi.

Andaj, i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj padinë dhe kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar dhe ta detyroj të paditurën që të bëjë kompensimin e shumës së precizuar në emër të kërkesave të lartcekura.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi, i ka pohuar faktet vendimtare duke theksuar se e konteston kërkesëpadinë e paditësit për kompensim të shujtave. Ka theksuar se padia nuk ka bazë juridike, ngase me dispozitat të kontratës kolektive në fuqi nga dt.18.04.2017, në nenin 46 të saj është paraparë se: MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht për ndarjen e mjeteve financiare për pagesën e obligimeve sipas dispozitave të nenit 35 paragrafët 5, 7 dhe 8, ndërsa e paditura nuk ka buxhet për kryerjen e këtyre obligimeve ndaj punëtorëve të arsimit. Ka shtuar se kjo kontratë kolektive sipas nenit 90.5 të ligjit të punës, vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me kontratën kolektive.

Andaj, i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 152 i Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se: *“po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim”*, lidhur me nenet 143 dhe 147 të të njëjtit ligj, nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij, dhe ka gjetur se në këtë çështje juridike kontestuese plotësohen kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor.

Gjykata, duke pasur parasysh faktin se i padituri i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor dhe administrimi i provave për faktet e pohuara.

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se nuk është kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura për disa vite përvojë pune, po ashtu nuk është kontestuese se e paditura nuk i ka paguar paditësit kompensimin për ushqim të shujtave ditore, për ditët e pranisë në punë për periudhën e kërkuar, pasi që një gjë e tillë nuk kontestohet nga palët, kjo vërtetohet dhe me provat materiale në shkresat e lëndës.

Andaj, gjykata, konform nenit 152 dhe 398 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke iu referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e dt.18.04.2017, konkretisht me nenin 35 par.7 është paraparë se: *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim.”*, por këtë nuk e ka bërë e paditura edhe pse ka qenë e obliguar ta bëjë këtë.

Po ashtu kjo është e rregulluar me Ligjin nr.03/L-212 e Punës, sipas nenit 90 par.4 të tij ku thuhet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhe të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se 3 (tri) vjet.”*, siç është dhe me këtë Kontratë (e cila ka qenë në fuqi konform nenit 45 par.2 të saj, deri me datën 22.01.2021), e që kjo çështje është rregulluar njëjtë dhe me dispozitat e nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë në fuqi nga data 22.01.2021 të cilat dispozita gjejnë zbatim në rastin e paditësit, si dhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës GJ.A-Su.A.214/2023 të datës 05.10.2023, i cili në pikën III, ka paraparë se: *“Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e lidhur më datë 22.01.2021, e nënshkruat nga Organizatat e të punësuarve (Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shkencës dhe Kulturës si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës -Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë), aplikohet në periudhën kohore nga data 22.01.2021 e deri me datën 21.11.2022.”*

Gjykata lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë vendosi duke u bazuar në Kontratën e Punës Nr. Protokollin ... të dt.01.09.2017, Vërtetimin mbi ditët e pranisë në punë të paditësit (duke iu llogaritur shujta nga 2 euro për një ditë të pranisë në punë), lëshuar nga SHFMU “N. G.” në fshatin B., P., Informatën e dhënë lidhur me prezencën në punë Nr.... të datës 16.02.2022 e lëshuar nga Komuna e Podujevës, Drejtoria e Arsimit për periudhën nga data 18.04.2017 deri me 31.12.2021, si provë, me ç ‘rast kemi të bëjmë me një dokument publik i cili ka fuqi të plotë provuese, e që në anën tjetër e paditura nuk i ka rrëzuar me prova materiale fuqinë provuese të këtij dokumenti, e gjithë kjo dhe bazuar në dispozitën e lart cituar të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, konkretisht nenit 35 par.7 të saj dhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës GJ.A-Su.A.214/2023 të datës 05.10.2023.

Gjykata i konsideron si të papranueshme dhe të pabazuara pretendimet dhe kundërshtimet e paditurës se ajo nuk ka asnjë obligim ndaj paditësit me arsyetim se nuk ka buxhet për të bërë këto pagesa në emër të kompensimit të kërkesës së paditësit, për çka edhe i ka propozuar gjykatës që padia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Kamatëvonesa është vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 382 të Ligji Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e palëve dhe provat tjera të ofruara, por vlerësoi se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të çështjes kontestimore si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449, 450, 452 dhe 453.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, Udhëzimit Administrativ të KGJK-së nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore si dhe Rregullores për Tarifat e Avokatëve e Odës së Avokatëve të Kosovës (2017). Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara u referohet për përpilimin e padisë shuma prej 78.00 euro, si dhe taksave gjyqësore të paguara për padi në shumë prej 20.00 eurove, duke marrë për bazë vetëm ato shpenzime të cilat kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjykatë.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e cekura më lartë.

**Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.646/2024, me datën 13.01.2025**

Gjyqtari:
Nazmi Neziri

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.